

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FAZA E POLITIKËS/E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Ne proces
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	12.12.2018 – 26.12.2018.
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	18.4.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?	XXXX
NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	[Viti – ML- nr. VN]
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL-I, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Emri, mbiemri, e-mail-i dhe numri i telefonit:

PJESA 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Në vitin 2014, me ligjin nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, u miratua dhe filloi nga zbatimi një skemë e veçantë e pensioneve të minatorëve e cila akordon përfitime në moshën 55 vjeç vetëm për punonjësit e minierave që kanë punuar nëntokë, që kanë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vite e më shumë dhe një periudhë pune në nëntokë mbi 12,5 vite. Në vitet e përgjithshme të sigurimit përveç punës në industrinë minerare dhe në ish ndërmarrjet shtetërore apo në sektorin privat, janë përfshirë edhe puna në ish kooperativa, vetëpunësimi në bujqësi si dhe koha e trajtimit të tyre me pagesë papunësie, në asistencë apo në trajtim financiar të veçantë, periudha për të cilat është paguar kontribut minimal, nga vetë përfituesit ose janë mbuluar me kontribute minimale nga shteti.

Kjo skemë zbatohet normalisht dhe aktualisht ka rreth 3100 përfitues ku rreth 90 % e tyre vijnë nga një skemë trajtimi e veçantë financiare me 60% të pagës me një periudhë minimale sigurimi 23 vjet, nga të cilat 11,5 vite në nëntokë. Ndër të tjera evidentojmë se kjo skemë përfitimesh përveç trajtimit me pension 15 vite përpara mbushjes së moshës për pension pleqërie, duke zbatuar skemën e pensioneve, rriti ndjeshëm, me rreth 40 %, përfitimet e personave që vinin në pension nga trajtimi financiar i veçantë.

Aktualisht, është kjo kategori personash, si dhe përfitues të pensionit të parakohshëm sipas skemës së miratuar në vitin 1995, të cilët kërkojnë trajtim financiar shtesë nga sistemi i pensioneve. Përgjithësisht ky është thelbi i kërkesës, ndërkohë që evidentohen për përmirësim edhe disa çështje të tjera të statusit të punonjësve që aktualisht punojnë në nëntokë. Kërkesat e tyre arrijnë deri në akordimin e përfitimeve shtesë në nivelin e 40 % të pagës minimale etj dhe natyrshëm adresohen për mbulim financiar me fonde buxhetore.

Në vitin 2014 kaluan në skemën e pensioneve dhe vazhdojnë të marrin pension rreth 3100 persona dhe pensionet e tyre variojnë nga niveli minimal deri në 90 % të pensionit maksimal. Rreth 65 % e tyre përfitojnë të ardhura minimale, kjo për arsye të nivelit mjaft të ulët të pagës. Për shkak të punëve të kryera ose edhe të evazionit të pagave për efekt të pagimit të kontributeve, realisht një pjesë e përfitimeve kanë rezultuar edhe nën nivelin minimal por e arrijnë atë nivel të ardhurash nëpërmjet skemave kompensuese të vendosura në periudhën 2007-2011. Në funksion të rritjes disi të përfitimeve të përlogaritura sipas formulës të përgjithshme të pensionit, është miratuar njohja si periudhë kontributive e të gjithë periudhës ndërkohë që përfituesi merrte trajtim financiar të veçantë. Kontributet për këtë periudhë janë paguar nga buxheti i shtetit në nivel minimal. Në këto kushte, aktualisht, megjithëse periudha e përgjithshme e sigurimit për këta persona është mbi 41 vite, tre të katërtat e asaj janë të mbuluara me kontribute minimale çka reflekton një pension nga niveli minimal deri në atë mesatar. Për më tepër, edhe për këtë kategori personash vjetërsia drejtpërdrejt në punë është minimale rreth 24 vjet ndërkohë që puna në nëntokë është rreth kufirit minimal të kërkuar. Mos përcaktimi rigoroz i llojit të punëve të industrisë së naftës dhe gazit që i përgjigjen kuptimit të plotë të termit “Naftëtar” dhe vështirësive që shoqërojnë ato lloje të punëve, paqartësitë në përcaktimin e disa kategorive të përfituesve apo të periudhave të sigurimit që lidhen me një përfitim të caktuar, jo vetëm që kanë shtuar ndjeshëm numrin e kërkesave dhe për pasojë parashikojnë rritje të ndjeshme të kostove, krahasuar me projektin e diskutuar dhe miratuar, por krijojnë padrejtësi dhe trajtime jo të barabarta për persona që kanë ushtruar të njëjtat profesione e punë por në degë të ndryshme të ekonomisë.

Përfitimet për personat të cilët kanë punuar në industrinë e naftës aktualisht përcaktohet sipas ligjit nr. 8/2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”. Mjaft kërkesa për marrjen e statusit “naftëtar” ka pasur edhe nga kategori punonjësish që kanë punuar në ndërmarrjet e naftës por që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me punët në shpim kërkimin shpim-shfrytëzim, prodhimin, sizmikës, gjeofizikës kantieriale, transportit me naftësjellës dhe gazsjellës, duke sjellë si pasojë prishje të qëllimit të këtij statusi dhe targetim të padrejtë të mbështetjes financiare që duhet të drejtohet në ato punë dhe profesione që me të vërtetë janë konsideruar shumë të vështira, të vështira dhe të dëmshme për shëndetin. Duke mos hartuar standarde të mirë përcaktuara, janë konstatuar edhe keq vlerësime të punëve kundrejt atyre që duhet të vlerësohen për marrjen e statusit.

Në dy ligjet e mësipërme nuk parashikohet i gjithë spektri i periudhave të sigurimit në profesione pune shumë të vështira, duke përjashtuar personat që kanë punuar në industrinë metalurgjike.

OBJEKTIVAT

Cilët janë objektivat dhe efektet e synuar të propozimit?

Përfitues, sipas këtij ligji, janë pensionistet që kanë përfituar pension sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pensionistet që kanë përfituar pension sipas ligjit nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë” punonjësit që kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë dhe do të plotësojnë kushtet e këtij ligji në vitet e ardhshme, punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit dhe personeli inxhiniero-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhimin, sizmikës, gjeofizikës kantieriale, përpunimit dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës si dhe punonjësit që kanë punuar në metalurgji në profesione, punë shumë të vështira; shkruar etj.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/të përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Lënia e situatës siç është aktualisht, pra, duke lënë pa mbulim personat të cilët kanë punuar në metalurgji. Ndrkohë që përfitimi për personat që kanë punuar në minierë dhe ata që kanë punuar në industrinë e naftës rregullohen me ligj të veçantë. Përkatësisht me ligjin nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë” dhe ligjit nr. 8/2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”, duke ruajtur edhe problematikat e shpjeguara në përkufizimin e problemit.

Hartimi i një ligji të ri i cili parashikon përfitime përpara kohës së mbushjes së moshës për pension si dhe përfitime shtesë mbi ato që akordohen nga ligji ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për tre kategori mjaft të veçanta punonjësish të cilët kanë punuar në miniera nëntokë, në industrinë e naftës si dhe në punë me një shkallë vështirësie shumë të lartë në metalurgji.

Personave të sipërsëhënuar u sigurohen përfitime suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si pension për shkak të profesionit (llojit të punës), shtesë mbi pensionin e pleqërisë, shtesë mbi pensionin e invaliditetit.

Përfituesit të cilët kanë përfituar, ose do të plotësojnë kushtet për të përfituar pension pleqërie sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kanë të drejtën e përfitimit të shtesës mbi pension kur kanë periudhë sigurimi në profesion; punonjësit e nëntokës 12.5 vjet; punonjësit e industrisë së naftës dhe të gazit; burrat 20 vjet, gratë 15 vjet, punonjësit e metalurgjisë; burrat 20 vjet, gratë 15 vjet.

Gjithashtu, punonjësit e këtyre industrive kanë të drejtën e trajtimit me pension për shkak të profesionit, deri në 15 vite përpara moshës së pensionit nga skema e detyrueshme.

Te fokusuar ne keto lloje trajtimesh, sindikatat kane sjelle obsione dhe propozime te ndryshme. Propozimet e tyre i referohen termit “ Pension” i cili ne kuptim te tij perfitohen pas mbushjes se nje moshe te caktuar per te gjithë popullsine dhe bazohet ne kontributet e derdhura. Ne rastin konkret per te gjithë perfituesit aktuale, qe jane pensioniste apo perfitues te pensioneve te parakoheshme kerkesa nuk ka natyren e pensionit, por te nje trajtimi financiar shtese i cili do te perballohet nga buxheti i shtetit.

Grupi i punes, i ngritur me urdherin e Ministrit te Financave dhe Ekonomise dhe Ministrit te Infrastruktures dhe Energjise nr 31, date 4.02.2019, per draftimin perfundimtar te projekt ligjit, ka perlllogaritur kostot e propozimeve te sindikatave ku rezulton se mbulimi i propozimeve te bera adresohet per mbi 27 mije perfitues me nje efekt financiar vjetor 3.7 miliard leke. Deri ne shuarjen e skemes, per shkak te moshes mesatare te perfutuesve aktuale, perllagaritet nje efekt financiar prej rreth 45 miliard leke i cili do te perballohet vetem nga buxheti, pasi kontributet suplementare te derdhura nga brezi qe eshte ne pune adresohen per ata persona. Gjithashtu propozimi i sindikatave, krijonte diskriminin edhe midis te njejtave kategorisht te te punesuarve, qe kane kryer pune te njejta por ne sektore te ndryshem te ekonomise nderkohe qe skema e ndertyar si e cilesuam edhe me lart eshte totalisht e mebeshtetur nga fondet buxhetore.

Duke çmuar dhe vlerësuar veshtiresite e propesioneve por edhe duke balancuar te drejtat si dhe kostor, projekt i paraqitur ka përcaktuar një efekt financiar vjetor prej 1,465 milione leke i cili adresohet për mbi 23900 përfutues ku përfshihen naftetarët, punonjësit e nentokës si dhe te metalurgjisë. Projekt ligji parashikon pensione te parakoheshme ne moshen 55 vjeç per personat qe jane ne pune aktualisht si dhe shitesa mbi pension per ish punonjesit e atyre industrive, tashme ne pension ku periudha minimale e sigurimit, nga jo me pak se 12,5 vjet eshte ulur ne 7 vite.

analiza e ndikimeve

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Referuar kushteve për pension sipas Ligjit, bazuar në të dhënat që disponohen si dhe në numrin aktual të punësuarve në industrinë e naftës, parashikohet që numri i personave që përfitojnë të arrijë në rreth 7600, nga 12500 që përlogaritej të ishte para ndryshimeve me një efekt financiar vjetor rreth 730 milionë lekë. Në projekt ligjin fillestar, efektet financiare ishin parashikuar rreth 400 milionë lekë ndersa sipas propozimeve, efekti përlogaritej mbi 1.4 miliard. Numri i përfituesve minatorë parashikohet të jetë rreth 13.3 mijë persona dhe efekti përlogaritjet rreth 520 milionë lekë në vit ndërsa për metalurgjinë, numri i përfituesve parashikohet të jetë rreth 2500 me një efekt financiar rreth 220 deri 250 milionë lekë.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara, përcaktohen qartësisht periudhat e punës në atë industri që njihen për efekt të llogaritjes së përfitimeve të parakohshme apo të përfitimeve shtesë. Gjithashtu, nëpërmjet ndryshimeve të propozuara krahasuar me dispozitat e mëparëshme, saktësohen dispozitat lidhur me llojet e përfitimeve, ribalancohen të drejtat si dhe harmonizohen kostot, duke u përafëruar me efektet financiare vjetore të përcaktuara në relacionin e projektligjit të propozuar.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lekë, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
1,460 milione	1510 milione	1595 milione

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?

Janë kryer disa konsultime me sindikatat e minatorëve dhe persona të interesuar si dhe disa takime të grupit ndërinstitucional të punës. Nga sindikatat e minatorëve është kërkuar që të miratohet statusi i vecantë dhe jo vetëm përfitimet suplementare të pensionistëve si dhe kërkojnë që masa e shtesës të pensionit të jetë më e lartë. Nga grupi i punës është sqaruar se ky ligj kërkon të trajtojë ato kategori që kanë punuar në punë të vështira duke vlerësuar shkallën e vështirësive së parë, minatorët. Për masën e përfitimit është vendosur në nenin 10 të ligjit që kjo do të indekssohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në takimet me specialistët e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë diskutuar kryesisht problemet e statusit të naftëtarëve pasi nuk ka përcaktime shumë të qarta për përfituesit. Është kërkuar dhe po punohet nga MIE që të bëhet një listë e profesioneve që përfshihen përveç atyre të parashikuara në VKM nr 526, dt.20.12.1958 "Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni".

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi i këtij projektligji do të behet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

PJESA 2. BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- Jepni kontekstin e politikës

Fillimisht, dhe sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.4.1966 "Për Sigurimet Shoqërore në RPSH", i ndryshuar, mosha e daljes në pension ishte 45-50 vjeç. Në atë periudhë përfituan pension rreth 5500 ish punonjës të nëntokës, të cilët aktualisht janë nga 71 deri 76 vjeç. Pavarësisht nga mosha e daljes në pension, vjetërsia e përgjithshme në punë e tyre ishte nga 30 deri 35 vjet dhe periudha e punës në minierë dhe në nëntokë, mesatarisht 20-25vjet. Për këtë kategori, pensionet janë përlogaritur sipas parimit të pagës përfundimtare (paga më e mirë e tre viteve në dhjetë të fundit shumëzuar me 70 %) . Këto pensione aktualisht kanë një masë përfitimi mesatar sa rreth 85-90 % të pensionit maksimal.

Në vitin 1995, për shkak të mbylljes masive të veprimtarisë prodhuese të minierave, u zbatua një skemë e pensioneve të parakohshme me 60 % të pagës, me kushtet 21 vjet vjetërsi e përgjithshme në punë nga të cilat, 10.5 vite punë në nëntokë. Duke qenë se personat me moshë deri 45 vjeç kishin dalë në pension, me ligjin e mëparshëm kjo skemë, trajtoi persona në moshën nga 37 deri në 45 vjet të cilët në limite, mund të plotësonin vjetërsinë e përgjithshme në punë dhe në nëntokë. Numri i përfituesve të kësaj skeme ishte rreth 8 000 dhe mosha aktuale e tyre varion nga 61 deri në 70 vjeç ndërkohë që vjetërsia në punë mesatarisht është rreth 22 vjet përfshirë këtu punë në ish kooperativa, ushtrinë ,punë në ndërmarrje të tjera dhe minimalisht 10.5 vite punë në nëntokë. Këto pensione aktualisht kanë një masë përfitimi mesatar sa rreth 80 % të pensionit maksimal, sepse edhe këto për shkak të dispozitave ligjore në fuqi për atë kohë, bazoheshin në parimin e pagës përfundimtare.

Pas vitit 1998 pothuaj të gjithë minierat e ndërprejnë plotësisht veprimtarinë ekonomike dhe në këto kushte u zbatua një skemë e re përfitimesh, e emërtuar trajtim financiar i veçantë me 60 % të pagës, por jo më pak se pensioni minimal, ndërkohë që periudha e përgjithshme e sigurimit duhet të ishte 23 vite nga të cilat 11,5 vite në nëntokë. Dokumentacioni u përgatit nga ndërmarrjet dhe vjetërsia e përgjithshme në punë dhe në profesion u konfirmua me një vërtetim të posaçëm nga ndërmarrja si edhe nga Ministria e Linjës. Në skemën e trajtimit financiar të veçantë u adresuan me dokumente të plota mbi 4900 persona, nga të cilët aktualisht mbeten në skemë rreth 3500 persona. Nga kjo kategori përfituesish, nga kontrollat e plota të ISSH, pas marrjes në dorëzim të dokumentacionit arkivor kanë rezultuar me dokumentacion të fallsifikuar dhe pa kushte të plotësuar mbi 1200 persona nga të cilët mbi 90 % gjenden debitorë. Për këta persona janë zbatuar procedurat e ndjekjes ligjore të veprimit abuziv. Nga këta persona, në vitin 2014 kaluan në skemën e pensioneve dhe vazhdojnë të marrin pension rreth 3100 persona dhe pensionet e tyre variojnë nga niveli minimal deri në

90 % të pensionit maksimal. Rreth 65 % e tyre përfitojnë të ardhura minimale, kjo për arsye të nivelit mjaft të ulët të pagës. Për shkak të punëve të kryera ose edhe të evazionit të pagave për efekt të pagimit të kontributeve, realisht një pjesë e përfitimeve kanë rezultuar edhe nën nivelin minimal por e arrijnë atë nivel të ardhurash nëpërmjet skemave kompensuese të vendosura në periudhën 2007-2011. Në funksion të rritjes disi të përfitimeve të përlllogaritura sipas formulës të përgjithshme të pensionit, është miratuar njohja si periudhë kontributive e të gjithë periudhës ndërkohë që përfituesi merrte trajtim financiar të veçantë. Kontributet për këtë periudhë janë paguar nga buxheti i shtetit në nivel minimal. Në këto kushte, aktualisht, megjithëse periudha e përgjithshme e sigurimit për këta persona është mbi 41 vite, tre të katërtat e asaj janë të mbuluara me kontribute minimale çka reflekton një pension nga niveli minimal deri në atë mesatar. Për më tepër, edhe për këtë kategori personash vjetërsia drejtpërdrejt në punë është minimale rreth 24 vjet ndërkohë që puna në nëntokë është rreth kufirit minimal të kërkuar.

Problemi në shqyrtim

- ***Përshkruani natyrën e problemit.***
- ***Identifikoni shkaqet e problemit.***
- ***Përshkruani shtrirjen e problemit.***
- ***Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria/biznesi /shoqëria civile /qytetarët.***
- ***Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.***

Skema e sigurimeve shoqërore të detyrueshme mbështetet në parimin kontributiv, në parimin e solidaritetit të brezave lidhur me krijimin e të drejtave dhe mbulimin e pagesave, në një formulë pensioni që bazohet në vitet e sigurimit dhe në madhësinë e kontributeve të paguara, e barabartë për të gjithë dhe pavarësisht nga veprimtaria ekonomike. Në këto kushte kjo skemë nuk mund të mbulojë përfitime të veçanta apo shtesë, të ndryshme nga parimet e përgjithshme. Çdo përfitim i veçantë mbetet të mbulohet më kontribute shtesë ose nga taksat e përgjithshme.

Duke konsideruar punën në miniera një punë shumë të vështirë, precedentët e krijuar si për trajtimet financiare të parakohshme ashtu edhe përfitimet shtesë nga pensioni i pleqërisë, pavarësisht se rreth 16 mijë përfitues aktualë kanë nga 18 deri në 25 vjet që trajtohen me pensione nga sigurimet shoqërore ose trajtime të veçanta financiare, projekt ligji parashikon, vazhdimin e pensioneve të parakohshme të mbuluar me kontribute shtesë dhe nga buxheti, si dhe vendosjen e një skeme trajtimi financiar shtesë mbi pension që varet nga vitet e punës në nëntokë e cila për të gjithë përfituesit aktualë dhe të atyre në 5 vitet e ardhëshme, mbetet të financohet pothuajse totalisht nga buxheti.

Ndërkohë, konceptohet që këto skema të jenë të përkohshme dhe të ndërpriten duke hapur rrugën e krijimit të fondeve profesionale të pensioneve të financuara nga kontribute të detyrueshme.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*

- Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshme, të arritshme, reale dhe në kohë.

Përfitues, sipas këtij ligji, janë pensionistet që kanë përfitur pension sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pensionistët që kanë përfitur pension sipas ligjit nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë” punonjësit që kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë dhe do të plotësojnë kushtet e këtij ligji në vitet e ardhshme, punonjësit që kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit dhe personeli inxhinierio-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sismikës, gjeofizikës kantieriale, përpunimit dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës si dhe punonjësit që kanë punuar në metalurgji në profesione, punë shumë të vështira; shkrirje etj.

Personave të sipërshtënuar u sigurohen përfitime suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si pension për shkak të profesionit (llojit të punës), shtesë mbi pensionin e pleqërisë, shtesë mbi pensionin e invaliditetit.

Përfituesit të cilët kanë përfitur, ose do të plotësojnë kushtet për të përfitur pension pleqërie sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kanë të drejtën e përfitimit të shtesës mbi pension kur kanë periudhë sigurimi në profesion; punonjësit e nëntokës 12.5 vjet; punonjësit e industrisë së naftës dhe të gazit; burrat 20 vjet, gratë 15 vjet, punonjësit e metalurgjisë; burrat 20 vjet, gratë 15 vjet.

Gjithashtu, punonjësit e këtyre industrive kanë të drejtën e trajtimit me pension për shkak të profesionit, deri në 15 vite përpara moshës së pensionit nga skema e detyrueshme.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- Përshkruani opsionin e status quo-së.
- Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.
- Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.

Lënia e situatës siç është aktualisht, pra, duke lënë pa mbulim personat të cilët kanë punuar në metalurgji. Ndrkohë që përfitimi për personat që kanë punuar në minierë dhe ata që kanë punuar në industrinë e naftës rregullohen me ligj të veçantë. Përkatësisht me ligjin nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë” dhe ligjin nr. 8/2017 “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”, duke ruajtur edhe problematikat e shpjeguara në përkufizimin e problemit.

Hartimi i një ligji të ri i cili parashikon përfitime përpara kohës së mbushjes së moshës për pension si dhe përfitime shtesë mbi ato që akordohen nga ligji ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për tre kategori mjaft të veçanta punonjësish të cilët kanë punuar në miniera nëntokë, në industrinë e naftës si dhe në punë me një shkallë vështirësie shumë të lartë në metalurgji.

Personave të sipërshtënuar u sigurohen përfitime suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të

ndryshuar, si pension për shkak të profesionit (llojit të punës), shtesë mbi pensionin e pleqërisë, shtesë mbi pensionin e invaliditetit.

Përfituesit të cilët kanë përfituruar, ose do të plotësojnë kushtet për të përfituruar pension pleqërie sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kanë të drejtën e përfitimit të shtesës mbi pension kur kanë periudhë sigurimi në profesion; punonjësit e nëntokës 12.5 vjet; punonjësit e industrisë së naftës dhe të gazit; burrat 20 vjet, gratë 15 vjet, punonjësit e metalurgjisë; burrat 20 vjet, gratë 15 vjet.

Gjithashtu, punonjësit e këtyre industrive kanë të drejtën e trajtimit me pension për shkak të profesionit, deri në 15 vite përpara moshës së pensionit nga skema e detyrueshme.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni se kush preket.
- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
 - Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.
- Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:
 - Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuar.
 - Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuar krahasohen me njëra-tjetrën.
 - Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).

Grupi i punës, i ngritur me urdherin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrit të Infrastruktura dhe Energji nr 31, datë 4.02.2019, për draftimin perfundimtar të projekt ligjit, ka përlogaritur kostot e propozimeve të sindikatave ku rezulton se mbulimi i propozimeve të bera adresohet për mbi 27 mijë përfitues me një efekt financiar vjetor 3.7 miliard leke. Deri në shuarjen e skemës, për shkak të moshës mesatare të përfutuesve aktualë, përllagaritet një efekt financiar prej rreth 45 miliard leke i cili do të perballohet vetëm nga buxheti, pasi kontributet suplementare të derdhura nga brezi që është në punë adresohen për ata persona. Gjithashtu propozimi i sindikatave, krijonte diskriminin edhe midis të njëjtave kategorisht të punësuarve, që kanë kryer punë të njëjta por në sektore të ndryshme të ekonomisë nderkohe që skema e ndërtuar si e cilesuam edhe më lart është totalisht e mebeshtetur nga fondet buxhetore.

Duke çmuar dhe vlerësuar vështirësitë e propozimeve por edhe duke balancuar të drejtat si dhe kostot, projekt i paraqitur ka përcaktuar një efekt financiar vjetor prej 1,465 milionë leke i cili adresohet për mbi 23900 përfitues ku përfshihen naftetarët, punonjësit e nëntokës si dhe të metalurgjisë. Projekt ligji parashikon pensione të parakoheshme në moshën 55 vjeç për

personat qe jane ne pune aktualisht si dhe shtesa mbi pension per ish punonjesit e atyre industrive, tashme ne pension ku periodha minimale e sigurimit, nga jo me pak se 12,5 vjet eshte ulur ne 7 vite.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Në këtë projektligj parashikohet që i gjithë spektri i periudhave të sigurimit në profesione pune shumë të vështira si në industrinë e naftës dhe të gazit, ashtu edhe në metalurgji të kenë konceptualisht një trajtim financiar të njëjtë. Për këto arsye projekti i paraqitur parashikon, ndarjen e përfitimeve në fushën e sigurimeve shoqëror dhe trajtimeve mbi pension, nga dispozitat që përcaktojnë një status të veçantë për industrinë e naftës dhe të gazit.

Në këtë ligj, pikërisht vendosja e një skeme të njëjtë trajtimi, për të gjithë kategoritë e punëve dhe pensioneve tepër të vështira është i vetmi parim që justifikon përdorimin e fondeve buxhetore për mbulimin e pagesave, për më tepër të pagesave shtesë. Shtesat e përfituesve për industrinë mekanike të naftës, si dhe ndryshimet në përcaktimin e moshës së përfitimit për disa kategori përfituesish të evidentuar në VKM 526/1958, jo vetëm që sjellin padrejtësi, rëndojnë kostot por edhe janë të vendosura me mendime dhe diskutime jo të bazuara në studime të mirëfillta ashtu si janë ndërtuar e vendosur në VKM nr.526/1958 i cili është zbatuar për rreth 60 vite. Gjithashtu, projekti i paraqitur fokusohet në saktësimin dhe zgjidhjen e disa problematikave që kanë dalë në procesin e identifikimit të personave që kanë punuar në industrinë e naftës dhe të gazit, verifikimin dhe plotësimin e dokumentacionit të tyre, për të realizuar dhënien e statusit dhe si pasojë të përfitimeve financiare që rrjedhin prej tij në fushën e pagave, pensioneve apo përfitimeve të tjera.

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.
- Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.

Për zbatim e këtij ligji do të përgjigjet Instituti i Sigurimeve Shoqërore përmes strukturave të tij, duke realizuar caktimin e përfitimeve, sipas këtij ligji.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmblendhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Me zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Llogaritja e pensioneve do të bëhet nga organet e sigurimeve shoqërore, ku kërkuesi ka qendrën e tij të banimit, njëlloj si për pensionet e pleqërisë, në varësi të momentit kur subjekteve përfituese ju lind e drejta për përfitim të pensionit.

Procedura e aplikimit, dokumentacioni i kërkuar, si dhe procedura e llogaritjes së pensionit do të përcaktohen me Rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe përfitimet do të jenë objekt auditimi nga strukturat audituese të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela. Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Tabela **ne milione leke**

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kostoja për buxhetin – një herë	1464									
Kostoja për buxhetin – në vazhdim	1464	1523	1515	1490	1488	1460	1389	1271	1120	939
Kostoja për biznesin – një herë	27.7									
Kostoja për biznesin – në vazhdim	28.8	28	28	23	20.5	18.3	17	15.8	30	11.8
Kostoja për grupet e tjera – një herë	27.7									
Kostoja për grupet e tjera – në vazhdim	28.8	28	28	23	20.5	18.3	17	15.8	30	11.8
Kostoja në total	55.5	56	57.7	45.7	41	36.6	34.1	31.6	29.7	23.5
Kostoja e zbritur në total = Kostoja në total x faktorin	1408	1466	1458	1444	1447	1423	1354	1239	1090	916
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kostoja për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë. Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kostoja	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	
Opsioni 2	1463.7	55	1408.2

Numri fillestar i kontribuesve llogaritet te jete rreth 5200 nga te cilet do te kontribuojne ne skemen publike rreth 1050, mbi moshen 47 vjeç dhe numri i tyre do te jete ne shuarje.

Bazuar ne numrin e pergjithshem te perfituesve shuma fillestare e kontributeve te punedhenesit dhe punemaresit perlogaritet 275 milione leke ne vit dhe arrin deri ne 328 milione leke, duke pasur parasysh rritmet aktuale te ketij biznesi. Kontributi si kosto e biznesit eshte ne nivelin 50 % te shumes, pasi 50 % parashikohet te paguhet nga punemaresi.

ISSH

Date 18.4.2019